



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

Nr. 71/2024

Datë: 08.08.2024

Mbështetur në nenin 5 paragrafin 1, neni 29, neni 36 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 dhe paragrafi 4, neni 37, neni 39 dhe neni 55 paragrafi 2 me nën paragrafin 2.1 i Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës (Gazeta zyrtare Nr. 14/7), Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2023 për Përcaktimin e Tregut Relevant si dhe Rregulloren Nr. 01/2023 për Procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me datën 08.08.2024, nxjerr:

K O N K L U Z I O N

për fillimin e procedurës hetimore ndaj:

- I. Artmotion Sh.p.k**, me numrin unik identifikues 810200866 me adresë në “Lidhja e Pejës”, p. n. (ish Fabrika e Amortizatorëve), 10000, Prishtinë;
Kujtesa Net Sh.p.k me numrin unik identifikues 810547862 me adresë në Preoc, km i 7-të magjstralja Prishtinë-Ferizaj.
Telkos L.L.C me numrin unik identifikues 810868995 me adresë në Rr. Elez Berisha nr. 30, 10000 Prishtinë.
ISP-Broadcast Sh.p.k me numrin unik identifikues 810011643 me adresë në Rr. 24 Maji nr. 46-1, 10000 Prishtinë; për shkak të dyshimeve se kanë arritur marrëveshje të ndaluar për të kufizuar ose eliminuar konkurrencën mes tyre, me objektivin e rritjes së çmimeve dhe fitimeve të ndërmarrjeve pjesëmarrëse duke fiksuar çmimet, duke bërë ndarjen e tregjeve, klientët ose territoret, manipuluar me oferta ose një kombinim të disa prej këtyre llojeve të veçanta të kufizimeve të konkurrencës në treg.
- II.** Autoriteti i Konkurrencës kërkon nga ndërmarrjet e lartcekura, si në dispozitivin **I** të këtij konkluzioni që në afat prej **30 ditësh** t’i sjellin në zyrat e Autoritetit këto dokumente:
 - a) Statutin e ndërmarrjes dhe dokumentet përcjellëse në ARBK.
 - b) Gjendjet e llogarive bankare nga viti 2021, 2022 dhe 2023 deri më sot, 08.08.2024, në të gjitha bankat brenda dhe jashtë vendit;
 - c) Kontratat për kontent ose Marrëveshjet e bashkëpunimit në mes të të gjithë operatorëve të lartcekur sipas dispozitivit **I** të këtij konkluzioni;
 - d) Pasqyrat Financiare për vitin 2021, 2022 dhe 2023 (të konsoliduar nëse janë pjesë e grupit me ndonjë kompani tjetër) ;

- e) Ofertat për secilin qytet në territorin e Republikës së Kosovës, për vitin 2021, 2022 dhe 2023;
- f) Për secilën prej palëve pjesëmarrëse në kartel, paraqisni një listë të të gjitha ndërmarrjeve që i takojnë të njëjtit grup dhe personat që kontrollojnë palët pjesëmarrëse në kartel, në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë;
- g) Të gjitha komunikimet në mes të operatorëve të lart cekur;
- h) Na siguroni, marrëveshjet ekskluzive që i keni me ofruesit e shërbimeve (provajderët);
- i) Hartën zonale, sipas komunave ku operoni në tërë territorin e Kosovës, me (numrin total të abonentëve/klientëve), për vitin 2021, 2022 dhe 2023.

III. Në rast se palët në procedurë nuk i dorëzojnë komentet dhe dokumentet e kërkuara si në dispozitivin **II** të këtij konkluzioni apo dorëzojnë dokumente të pa-sakta apo të rreme, Autoriteti do të konstatojë shkeljen e këtij ligji dhe do t'u shqiptojë palëve sanksionin administrativ deri në 1% të qarkullimit të përgjithshëm që ka realizuar në tërë botën në vitin e fundit, për të cilin është përmyllur raporti financiar dhe pastaj do të vazhdojë procedurën hetimore duke i përdorur instrumentet tjera ligjore të përcaktuara, me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

IV. Ky konkluzion hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Komisionit.

A r s y e t i m

Autoriteti i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare, pas monitorimit të tregut përkatës dhe pas marrjes së informatave, konstaton se ekziston dyshim i bazuar se operatorët kabllor, Artmotion sh.p.k; Kujtesa Net sh.p.k, Telkos l.l.c dhe ISP-Broadcast sh.p.k, kanë arritur marrëveshje të ndaluar sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës për fiksimin e çmimeve për zona të ndryshme gjeografike në Republikën e Kosovës duke kufizuar dhe shtrembëruar konkurrencën e lirë në tregun përkatës. Autoriteti i Konkurrencës nga informacionet e siguruar, dyshon se ndërmarrjet e mësipërme kanë bashkërenduar aktivitetet e tyre, duke fiksuar çmimet si dhe ndarjen e tregjeve në zonat gjeografike.

Andaj, në bazë të sjelljeve të ndërmarrjes në tregun përkatës, Autoriteti dyshon se ndërmarrjet kanë penguar, kufizuar konkurrencën në tregun përkatës, duke fiksuar çmimet, kufizuar tregjet dhe burimet e furnizimit.

PALËT NË PROCEDURË:

Palë në procedurë të zhvilluar nga Autoriteti i Konkurrencës konsiderohen ndërmarrjet:

1. Artmotion sh.p.k – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me NUI 810200866
2. Kujtesa Net sh.p.k – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me NUI 810547862
3. Telkos l.l.c – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me NUI 810868995
4. ISP-Broadcast sh.p.k – Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me NUI 810011643

PËRSHKRIMI I GJENDJES FAKTIKE:

Autoriteti i Konkurrencës për të adresuar dyshimet lidhur me kufizimin e konkurrencës, përmes sjelljeve anti konkurruese – marrëveshjeve të ndaluara, që zakonisht janë të kushtëzuara dhe në kundërshtim me nenin 5, paragrafin 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nxorri këtë konkluzion për fillimin e procedurës hetimore.

Në bazë të sjelljeve të ndërmarrjes në tregun përkatës, Autoriteti dyshon se ndërmarrjet kanë penguar, kufizuar konkurrencën në tregun përkatës, duke fiksuar çmimet, kufizuar, ndarë tregjet dhe burimet e furnizimit.

Nga sa u tha më lart, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 1, nënparagrafët 1.1, të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, vendosi si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni për fillimin e procedurës hetimore nuk është e lejuar ankesa as padia për inicimin e konfliktit administrativ.

AUTORITETI I KONKURRENCËS



Kaltrina Sela
Nënkryetare

Florent Mehmeti
Anëtar

Nafije Osdautaj
Anëtare

Salihe Gashi Loku
Anëtare

Me këtë KONKLUZION të njoftohen:

- *Artmotion Shpk;*
- *Kujtesa Net Shpk;*
- *Telkos l.l.c;*
- *ISP-Broadcast sh.p.k*
- *Arkiva.*

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni Nr. 21, 10000, Prishtinë, Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës Kati i VI, Zyra nr. 601
Tel: +383/0/38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks-gov.net